

WE ARE YOUR DOL



Department of Labor

PASQYRË E LIGJEVE

Që mbrojnë TË GJITHË punëtorët/et në shtetin e Nju Jorkut

Kjo fletë të dhënash është një përmbledhje e ligjeve në shtetin e Nju Jorkut që ju mbrojnë si punëtor/e. Departamenti i Punës i Shtetit të Nju Jorkut, i cili mbikëqyr këto ligje, mbron TË GJITHË punëtorët/et nga vjedhja e pagave, pavarësisht nga statusi i tyre i imigracionit. Nëse punoni kudo në shtetin e Nju Jorkut, edhe nëse jeni pa dokumente, emigrant/e ose azilkërkues/e, ju jeni të mbrojtur me ligj. Në shtetin tonë, punëdhënësit DUHET të ofrojnë pagën minimale për orë dhe përfitimet shtesë të renditura më poshtë.

POSTER PËR PAGËN MINIMALE

Të gjithë punëtorët kanë të drejtë të marrin të paktën një pagë minimale për çdo orë të punës. Këtu përfshihen punëtorët/et e sektorit të Fast Food-it, punonjësit e salloneve të thonjve, punëtorët/et me bakshishe dhe më shumë, pavarësisht nga statusi i imigracionit.

| VENDNDODHJA | PAGA MINIMALE (QË NGA 01.01.2024) | PUNONJËS/E SHËRBIMI ME BAKSHISH* (QË NGA 01.01.2024) | PUNONJËSIT E SHËRBIMIT TË USHQIMIT ME BAKSHISH* (QË NGA 01.01.2024) |
|---|--------------------------------------|--|---|
| Qyteti i Nju Jorkut | \$16.00/orë | \$13,35 Paga Cash \$2,65 kredit bakshishi | \$10,65 Paga Cash \$5,35 kredit bakshishi |
| Long Island dhe Westchester | \$16.00/orë | \$13,35 Paga Cash \$2,65 kredit bakshishi | \$10,65 Paga Cash \$5,35 kredit bakshishi |
| Pjesa tjetër e shtetit të Nju Jorkut | \$15.00/orë | \$12,50 Paga cash \$2,50 Kredit bakshishi | \$10,00 Pagë cash \$5,00 kredit bakshishi |

Ligji i shtetit të Nju Jorkut i lejon punëdhënësit në disa industri si hotelet, restorantet dhe catering të kombinojnë atë që paguhet nga punëdhënësi nëse punëdhënësi merr mjaftueshëm bakshish nga klientët. Për shembull, një restorant në qytetin e Nju Jorkut mund të paguajë 10 dollarë në orë (e quajtur "paga në para të thata") nëse punonjësi/ja fitoi mesatarisht të paktën 5 dollarë në orë bakshish atë ditë ("kredit i bakshishit"). Punonjësit/et e shërbimit ushqimor përfshijnë stafin e pritjes, banakierët dhe personelin e pastrimit të tavolinave. Kjo NUK përfshin punëtorët e dërgesave. Punonjësit/et e shërbimit me bakshishe janë punëtorë të tjerë, si personeli i shërbimeve në restoranteve dhe punëtorët/et e pastrimit, të cilët zakonisht marrin bakshishe.

Të gjithë punonjësit/et e tjerë/a jo të mikpritjes, duke përfshirë ata në sallonet e thonjve dhe lavazhet, kujdestarët e parkingut dhe parukierët DUHET të paguhet me pagën minimale të plotë edhe nëse marrin bakshish.

PUNA JASHTË ORARIT

Shumica e punonjësve/eve duhet të paguhet me tarifë një e gjysëm të pagës së tyre për çdo orë të punuar mbi 40 orë në javë.

PERIUDHAT E NGRËNIES

Punëdhënësit në shtetin e Nju Jorkut duhet t'u sigurojnë të gjithë punonjësve/eve kohë pushimi për ushqim, pasi të kenë punuar një numër të caktuar orësh. Në përgjithësi, punëdhënësit duhet të ofrojnë të paktën 30 minuta pushim pa pagesë nëse një punonjës/e punon më shumë se 6 orë.

FREKUENCA E PAGESËS

Ligji i Shtetit të Nju Jorkut kërkon që punëtorët/et e krahut

të paguhet çdo javë dhe nëpunësit/et, si edhe punëtorë të tjerë të paktën dy herë në muaj.

NJOFTIMET PËR PUNONJËSIT/ET

Punëdhënësvet u kërkohet të japin njoftimet e mëposhtme për punonjësit/et:

- Deklaratat e Pagave (vërtetimi i pagës) me çdo pagesë të pagave
- Njoftimi i pagës, njoftimi i normave të pagës dhe ditës së pagës së bashku me informacione për orët dhe përfitimet si pushimi, sigurimi, etj.
- Njoftimi i Ndërprerjes së Punës, i cili është një njoftim me shkrim për një punonjës/e brenda pesë ditëve të punës nga përfundimi i punës së tyre

PUSHIM MJEKËSOR I PAGUAR

Të gjithë punëtorët/et e sektorit privat (jo-qeveritar) në shtetin e Nju Jorkut mbulohen nga ligji i shtetit për lejen e pushimit të sigurt kur janë të sëmurë. Kjo do të thotë që ju keni mundësinë të merrni pushim nëse jeni sëmurë. Sasia e kohës, edhe nëse është e paguar ose e papaguar, varet nga madhësia e biznesit për të cilin punoni. Punëtorët/et në çdo lloj pune janë të mbuluar edhe ata që punojnë me kohë të pjesshme ose sezonale.

HAKMARRJA NDAJ PUNËTORËVE/EVE

Raportimi i një problemi të mundshëm ose një aktiviteti të paligjshëm të punëdhënësit tuaj mund të duket i frikshëm, por punëdhënësit nuk mund t'ju ndëshkojnë për njoftimin për shkeljet e ligjit të punës ose për ofrimin e informacionit në Departamentin e Punës. Nëse raportoni një shkelje, punëdhënësi juaj nuk mund t'ju pushojë nga puna, t'ju shkurtojë pagën ose orët, t'ju ricaktojë në një vend tjetër ose t'ju zbrësë në pozicion. Nëse ata kërcënojnë se do të ndërmarrin veprime, do t'ju raportojnë, do t'ju dëbojnë ose ndonjë gjë tjetër, kjo është e paligjshme.

KOMPENSIMI I PUNONJËSVE

Nëse lëndoheni ose sëmurëni si rezultat i drejtpërdrejtë i punës suaj, ka ndihmë për ju. Shteti i Nju Jorkut kërkon që punëdhënësit të ofrojnë mbulim sigurimi të kompensimit të punëtorëve/eve për çdo punëtor/e, pavarësisht nga shtetësia dhe/ose statusi i imigracionit. Në rast të një dëmtimi ose sëmundjeje të lidhur me punën, ky sigurim paguan për kujdesin mjekësor dhe siguron zëvendësim të pjesshëm të pagës nëse nuk jeni në gjendje të punoni (ose fitoni më pak) për shkak të lëndimit ose sëmundjes suaj. Mund të mësoni më shumë duke vizituar linkun wcb.ny.gov ose telefononi **877-632-4996**. Shërbimet falas të ndihmës gjuhësore janë të disponueshme nëse dëshironi informacion në një gjuhë të ndryshme nga anglishtja.

PARAQISNI NJË ANKESË

Departamenti i Punës ndihmon në mbledhjen e pagave që u detyrohen punëtorëve/eve që nuk kanë marrë pagën minimale, pasi të paraqesin një kërkesë tek ne.

PAGAT E PAPAGUARA

- Punëdhënësi juaj nuk ju ka paguar për të gjitha orët e punës
- Çeku i pagës suaj nuk u pranua sepse nuk kishte fonde të mjaftueshme
- Ju nuk i keni marrë të gjitha bakshishet tuaja
- Norma juaj e pagës u ul pa njoftim paraprak

SHTESAT E PAPAGUARA TË PAGAVE

- Punëdhënësi ju ka premtuar (me gojë ose me shkrim), por nuk ka dhënë pagesën e ditëve pushime, pagesën e pushimeve, shpërblimet, etj.

PAGA MINIMALE/JASHTË ORARIT

- Punëdhënësi ju ka paguar më pak se paga minimale.
- Punëdhënësi juaj nuk ka paguar tarifën jashtë orarit për orët e punës mbi 40 në një javë.

ELEMENTE QË NUK LIDHEN ME PAGAT

- Punëdhënësi juaj dështoi të sigurojë periudhën e kërkuar të vaktit, ditën e pushimit, mandat page, njoftimin e pagesës, pagesën në kohë të pagave ose ndërmori një veprim negativ kundër jush për bërjen e një ankese.

FORMULARËT E ANKESAVE

- Anglisht: dol.ny.gov/labor-standards-complaint-form-ls223
- Shqip: dol.ny.gov/ls223al-albanian-labor-complaint-form
- Arabisht: dol.ny.gov/ls223ar-arabic-labor-complaint-form
- Bengalisht: dol.ny.gov/ls223bn-bengali-labor-complaint-form
- Kineze: dol.ny.gov/ls223c-chinese-labor-complaint-form
- Frengjisht: dol.ny.gov/ls223f-french-labor-complaint-form
- Greqisht: dol.ny.gov/ls223g-greek-labor-complaint-form
- Kreole Haitiane: dol.ny.gov/ls223hc-haitian-creole-labor-complaint-form
- Hindi: dol.ny.gov/ls223h-hindi-labor-complaint-form
- Italisht: dol.ny.gov/ls223i-italian-labor-complaint-form
- Japonisht: dol.ny.gov/ls223j-japanese-labor-complaint-form
- Koreanisht: dol.ny.gov/ls223k-korean-labor-complaint-form
- Polonisht: dol.ny.gov/ls223p-polish-labor-complaint-form
- Portugalisht: dol.ny.gov/ls223pg-portuguese-labor-complaint-form
- Rusisht: dol.ny.gov/ls223r-russian-labor-complaint-form
- Spanjisht: dol.ny.gov/ls223s-spanish-labor-complaint-form
- Urdu: dol.ny.gov/ls223ur-urdu-labor-complaint-form
- Jidisht: dol.ny.gov/ls223y-yiddish-labor-complaint-form

PARAQISNI FORMULARËT E PLOTËSUAR TË KËRKESËS NË:

**NYS DOL, Divizioni i Standardeve të Punës
Kampusi i Zyrës Shtetërore
Ndërtesa 12, Dhoma 266B Albany, NY 12226**

Nëse keni nevojë për ndihmë shtesë për të paraqitur ankesën tuaj, ju lutemi telefononi: **1-888-469-7365**.